



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.10.2018, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar””. *(Nismë deputeti; komision përgjegjës)*
3. Projektligji “Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar””. *(Nismë deputeti; komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglandina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Rrahman Rraja, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Erion Braçe – deputet

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përsëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Besoj se jeni njohur me axhendën e kësaj jave. Sot do të diskutojmë një nismë për amendimin e ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar”, e propozuar nga kolegu Erion Braçe. Ndërkohë, jeni në dijeni që nesër në orën 9:00 do të shqyrtojmë dekretin e Presidentit.

A jeni dakord me axhendën e kësaj jave? Po.

Në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar, a ka ndonjë koment apo sugjerim?

Miratohet procesverbali.

Atëherë, para se të kalojmë te prezantimi, i uroj mirëseardhjen në komision zotit Braçe! Fillimisht do të dëgjojmë prezantimin e kolegut.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po i jap fjalën zotit Braçe të prezantojë nismën. Më pas kolegët do të bëjnë pyetje. Në fund mund të bëhen komente, sugjerime apo vërejtje.

A jeni dakord me rendin e ditës? Në rregull.

Zoti Braçe fjala për ju.

Erion Braçe – Faleminderit, zoti kryetar, që më jepni mundësinë të prezantoj dy nisma ligjore, të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me probleme konkrete që lidhen me çështjen e pronësisë së tokës bujqësore, me proceset e zhvilluara në raport me të dhe, natyrisht, përmbushin interesa jo vetëm të banorëve të atyre zonave, por edhe të deputetëve që mbulojnë në Kuvendin e Shqipërisë zona përgjithësisht rurale, të cilat kanë probleme të këtij lloji çdo ditë.

Dua t’ju informoj se po vij nga Komisioni i Ligjeve, një komision që është përcaktuar nga Konferenca e Kryetarëve për dhënie mendimi lidhur me këto dy projektligje, ku ishin prezentë ministri i Bujqësisë, edhe zëvendësministri i Drejtësisë. Prezantimi im në komision lidhet, dhe nuk ndryshon gjë në përmbajtje në raport me mua, me angazhimin që mori qeveria në komisionin tjetër për këtë gjë, pra një informacion që e ndau me ne dhe që e mori.

Megjithatë, unë po u referohem dy nismave të mia. Natyrisht, dua të sqaroj dy gjëra që në krye të herës. Nuk bëhet fjalë për të ndarë tokën nga fillimi, pra nuk bëhet fjalë për të ndarë tokën, që sot është e lirë dhe që duhet t’ua vëmë në dispozicion familjeve bujqësore, qofshin këta edhe individë që merren me bujqësinë në fshat. Pra, bëhet fjalë për tokë të

ndarë, që është shoqëruar me akt të marrjes së tokës në përdorim dhe që më herët, para viteve '90, ka qenë në administrimin e ndërmarrjeve bujqësore. Pra, vetëm me këtë tipologji. Për shembull, nuk bëhet fjalë për tokat e ndara me ligjin nr. 7501, por bëhet fjalë për tokën e cila ka qenë në administrimin e ndërmarrjeve bujqësore, pastaj i është nënshtruar procesit të ndarjes për familjet bujqësore dhe individët që janë marrë me bujqësi në atë periudhë. Kjo është e para që doja ta sqaroja.

Së dyti, ka disa tipologji, të cilat unë jam munduar bashkë me një grup specialistësh, qoftë edhe me drejtues të pushtetit vendor t'i adresojmë me këto dy nisma për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare problematikës që haset sot në territore rurale dhe, mbi të gjitha, në territoret bujqësore.

Së pari, ka të bëjë me çështjen e vendosjes në ato territore të familjeve bujqësore, Kjo do të thotë se ligji ka vendosur si kufi datën 1 gusht të vitit 1991: që të përfitojë tokë dhe ta përfitojë këtë tokë në pronësi, duhet të provojë që pasaportizimi yt në këtë territor ka ndodhur para datës 1 gusht 1991. Ka ndodhur në këto territore që familjet bujqësore të jenë vendosur fizikisht në territoret, për të cilat bëhet fjalë, para datës 1 gusht i vitit 1991, por për shkak të situatës që ishte në atë periudhë, veçanërisht në institucione, dhe përgjegjësinë e tyre për t'i dhënë zgjidhje edhe këtij problemi, pra pasaportizimit të këtyre familjeve në këto territore, ka ndodhur që pasaportizimi të ketë ndodhur pas datës 1 gusht të vitit 1991. Për këtë arsye këto familje janë pajisur me tokë nga komisionet e ndarjes së tokave në atë periudhë, kanë marrë tokën sipas normës për frymë, që ishte vendosur në legjislacionin në fjalë, por toka e tyre ka mbetur në përdorim, sepse ligji ndalon apo kufizon marrjen e tokës në pronësi për këto familje, të cilat kanë provuar që pasaportizimi i tyre ka ndodhur pas datës 1 gusht të vitit 1991. Ndryshimi propozon se, veç zhvendosjes së kësaj date secila prej këtyre familjeve, duhet të provojë dy gjëra: së pari, që është vendosur faktikisht në këtë territor para datës 1 gusht të vitit 1991 dhe që ka mundësi që ta provoj, për shembull, regjistrimi i fëmijëve në shkollë para kësaj date në këto territore është një element i rëndësishëm për ta paraqitur si provë; së dyti, të provojnë që në zonën, ku kanë banuar më herët dhe nga e cila kanë ardhur dhe janë vendosur këtu para datës 1 gusht të vitit 1991 nuk kanë marrë apo nuk kanë përfituar tokë qoftë me ligjin nr. 7501 qoftë me ligje të tjerë. Kjo është një tipologji që është më masivja, sidomos në zonën e Myzeqesë.

Cila është kategoria tjetër apo tipologjia tjetër?! Është tipologjia e familjeve bujqësore apo edhe individëve, të cilët në periudhën apo në momentin kur ka ndodhur procesi i regjistrimit të tokës pas ndarjes për efekt të certifikimit të saj e certifikatë pronësie nuk kanë qenë në këtë territor, por kanë qenë në emigracion, nuk kanë qenë pjesë e këtij procesi, mund

të jenë zhvendosur brenda territorit të vendit për një apo për disa arsye, por vendbanimin e përhershëm, natyrisht edhe pasaportizimin e ka pasur në këto territore, apo janë harruar fare në procesin e regjistrimit të kësaj toke. Domethënë, me ligjin që është sot në fuqi, për shkak se ka ndryshuar vendbanimi në kohë të caktuara, këtyre familjeve pavarësisht se e shfrytëzojnë atë tokë nuk u jepet e drejta e ndjekjes së procedurës të marrjes së tokës në pronësi.

Tipologjia e tretë ka të bëjë me ato familje, të cilat janë zhvendosur me vendime të Këshillit të Ministrave nga pjesë të ndryshme të territorit të vendit në brendësi të territorit vendosur në këto zona, pra në tokat që janë administruar nga ndërmarrjet bujqësore. Toka për ta është ndarë përsëri me atë normë të përcaktuar me vendimet e Këshillit të Ministrave për frymë. Natyrisht, pavarësisht se u është dhënë mundësia që ta kalojnë tokën në pronësi, për shkak të një afati që është vendosur në ligj dhe që skadon pas dy muajsh, më 31.12.2018, të gjitha këto familje mund të humbin të drejtën e marrjes së tokës në pronësi. Këto janë tri tipologjitë që janë adresuar në këtë ligj, për të cilat unë doja të merrja vëmendjen tuaj. Por ka edhe një element tjetër, që është në ligjin tjetër për vlefshmërinë dhe verifikimin e titujve të pronësisë, që i jep një definicion të ri përdoruesve faktikë të tokës. Cilin problem kërkon të zgjidhë kjo, sepse pashë edhe në komisionin tjetër që kjo mund të ketë krijuar pështjellim. Në fakt, janë dy: i pari është kur u nda toka në vitin 1991, e cila u është vënë në dispozicion edhe atyre që ishin punonjës në strukturat shtetërore, por që banonin në këto territore. Atyre u është dhënë 1 mijë metra katrorë për frymë dhe jo më shumë se 4 mijë metra katrorë secilit prej tyre, por që për shkak të punës së tyre ndër vite apo për arsye të tjera objektive e kanë lënë tokën djerrë. Prej vitesh toka e tyre është djerrë, por në dokumentet zyrtare figuron si tokë e regjistruar në përdorim për ta. Kjo tokë natyrisht që nuk mund të jetë pafundësisht me këtë status, sepse në regjistrat e zyrës së regjistrimit të pasurive statusin juridik e ka tokë shtet dhe duhet të vihet në funksion, qoftë edhe duke e marrë aty ku është titulli juridik, te shteti, dhe duke e vënë në dispozicion për ta zhvilluar.

Elementi i dytë ka të bëjë me ata që kanë marrë tokë në pronësi, por për shkak të një mijë e një arsyeve të tjera janë turrur dhe kanë zaptuar edhe sipërfaqe toke tjetër. Ne propozojmë që kjo tokë nuk mund të konsiderohet si një tokë e marrë në përdorim nga këta njerëz. Kush ka marrë tokë në pronësi, nuk mund të marrë tokë tjetër në përdorim. Këta njerëz duhet ta dorëzojnë këtë tokë dhe për këtë kërkojmë një proces verifikimi për mënyrën sesi këta e disponojnë këtë tokë sot që po flasim. Këto janë 4 elementet që lidhen në një pikë të vetme, e cila ka të bëjë me afatin 31.12. 2018, datë që mbaron funksionimi i këtij ligji.

Më lejoni t'ju jap disa shifra. Vetëm në Bashkinë e Divjakës, që unë e kam me shifra zyrtare, janë këto të dhëna: deri tani, nga tokë e ndërmarrjeve bujqësore, që është administruar para viteve '90 nga ndërmarrjet bujqësore, në pronësi ka kaluar vetëm 6030 hektarë dhe më shumë se gjysma e kësaj sipërfaqeje, 3357 hektarë është tokë me akt të marrjes së tokës në përdorim, e cila është një shifër e konsiderueshme 3300 hektarë, nga të cilat, me vendim të Këshillit të Ministrave, 715 hektarë janë tokë për familjet bujqësore që janë zhvendosur në atë territor, tokë e familjeve bujqësore, që ka problematikën e fortë të datës 1 gusht të vitit 1991 dhe të ndryshimit të vendbanimit janë edhe 1283 hektarë të tjerë. Pra, 6000 hektarë kanë kaluar në pronësi, 3357 hektarë janë ende në përdorim, nga të cilat mbi 2000 hektarë kanë problematikën për të cilën unë ju fola, që në datën 31 dhjetor duan një zgjidhje. Ligji i kufizon dhe i ndalon që ata të nisin procedurën e marrjes së tokës në pronësi, ndërkohë që njerëzit, të cilët e kanë marrë këtë tokë para 20 vjetësh, e përdorin për nevoja të tyre dhe e kanë bërë pjesë të ekonomisë së tyre familjare dhe duan një zgjidhje përfundimtare. Siç ju thashë, toka në përdorim në titullin juridik vazhdon të jetë, sot e gjithë ditën, tokë e shtetit, ndërkohë që duhet t'u kalojë në pronësi këtyre njerëzve. Këto dy projektligje, që unë kam paraqitur, kërkojnë të zgjidhin pikërisht këtë problematikë dhe duhet të shoqërohen me ndryshime në VKM-të respektive, që kanë dalë në zbatim të tyre.

Në Komision e Ligjeve qeveria bëri me dije se është në një proces hartimi të dy ligjeve, me të cilat synon të zgjidhë përfundimisht çështjet që janë sot shqetësime në procedurat e kalimit të tokës në pronësi për këto familje, duke përfshirë edhe këto dy probleme. Qeveria thotë se është në fazën përfundimtare të hartimit të këtyre ligjeve dhe pretendon që brenda këtij viti t'i sjellë.

Po e përsëris edhe një herë, shqetësimi im lidhet me datën 31 dhjetor të vitit 2018, kur fuqia e këtyre dy ligjeve mbaron dhe këtyre mijëra hektarë, që përkthehen në disa qindra, po flas vetëm për territorin që e njoh në detaje, në pjesën më të madhe të Myzeqesë dhe më gjerë se Myzeqeja, sepse ndërmarrjet bujqësore kanë qenë të përhapura pothuajse në të gjitha ato zona, ku u synua një zhvillim më intensiv i bujqësisë para viteve '90, të cilat prekin një numër të konsiderueshëm familjesh bujqësore, do të duhet t'u japim një zgjidhje para kësaj date. Arsyeja e kësaj zgjidhjeje sa më të shpejtë është që të mos kalojmë në panik dhe, në krahun tjetër, të mos krijojmë shqetësime tek ato familje që në këtë datë mund të jenë në mes të ciklit të prodhimit bujqësor për atë stinë apo atë sezon. Kështu që, unë kërkoj mirëkuptimin tuaj që të mbështesim vendosjen e një afati për qeverinë, në rast se ka dy nisma akoma më përfshirëse, që përfshijnë edhe dy propozimet e mia, brenda nëntorit të këtij viti, me qëllim që të kemi edhe një zgjidhje përfundimtare, e cila të bëhet efektive edhe sipas procedurave

ligjore të hyrjes në fuqi të ligjit, në mënyrë që të mos krijojmë vakum në datën 1 janar të vitit 2019. Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zot Braçe!

Në fakt, kjo nismë meriton një përgëzim, sepse, me sa mbaj mend, këtë çështje dhe këtë kategori familjarësh e kemi diskutuar para shumë vitesh, por që kanë munguar iniciativat konkrete, të cilat mund të përmirësoheshin, mund të ndryshoheshin dhe amendoheshin dhe sot kemi një iniciativë konkrete.

Nga pikëpamja procedurale unë kam kërkuar të jenë prezentë përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, që sot janë në statusin e dëgjuesit, por që shumë shpejt do të jenë edhe me komentet konkrete, sepse zoti Braçe niset nga një problematikë me shifra të sakta për Divjakën, por është një problematikë që përfshin të gjithë Shqipërinë. Nëse i kemi të dhënat për Divjakën, besoj se ministria do t'i ketë për të gjithë Shqipërinë.

Vijojmë me pyetjet. Fjalën e ka zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj- Ne kemi dy projektligje. I pari ka të bëjë me përfundimin e procesit ligjor të kalimit të tokës së ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve, i ndryshuar.

Fillojmë me projektligjin e parë. Në pikën dy, te ndryshimet që ju keni propozuar, te pika (iii) thoni...

(Diskutime në sallë)

(iii) thoni: “Përdorimi i tokës për veprimtari bujqësore dhe që disponojnë aktin e marrjes së tokës në përdorim”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Kush tha që nuk e kemi bërë ne?

Vullnet Sinaj – ... regjistruar deri në datën 31.12.1993”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, unë dua të di: pse keni vendosur datën 31.12.1993?

Erion Braçe – T’i përgjigjem kësaj pyetjeje?

Vullnet Sinaj – Po.

Erion Braçe – Faleminderit!

Pra, shqetësimi ka lindur nga data 1 gusht i vitit 1991 dhe kufizimet që kjo datë vendos për ato familje që fizikisht, faktikisht, kanë ardhur para datës 1 gusht të vitit 1991, por pashaportizimin e kanë bërë më pas. Propozimi ynë është që kjo datë t’u hiqet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja ta shpjegoj deri në fund!

Propozimi në një nen më përpara është që t'i hiqet kjo datë, ndërkohë që do të duhet të ketë një datë, dhe pikërisht data 31.12.1993 lidhet me një fakt shumë të rëndësishëm, që toka, edhe e këtyre ndërmarrjeve bujqësore, në shumicën dërrmuese të territorit të vendit dhe të rasteve, është ndarë deri më 31.12.1993. Pas kësaj date, nga e gjithë konsulta që kam unë me specialistë të kësaj fushe, me specialistë që kanë menaxhuar ndarjen e tokës në territor e të tjerë me radhë, mund të ketë pasur raste shumë specifike të ndarjes së tokës, në përputhje me ligjin, por pas kësaj date kanë ndodhur abuzime të tmerrshme me dhënien e tokës në përdorim, veçanërisht në ato komisione që kanë qenë në zona jashtë vëmendjes. Prandaj është vendosur kjo datë, me qëllim që të krijohet edhe mundësia e verifikimit të titujve pas datës 31.12.1993, sepse realisht kanë ndodhur problematika tejet të mëdha me tokat e ndërmarrjeve bujqësore, veçanërisht në ato territore ku ka pasur edhe interes shumë më të madh, siç janë territoret në zonat bregdetare, të cilat gjithashtu janë administruar para viteve '90 nga ndërmarrjet bujqësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Me mikrofon, Vullnet!

Vullnet Sinaj – Pra, ju keni një qëllim të caktuar për informacionin që keni në zonën tuaj. Po atyre që kanë probleme pas kësaj date, ne ua mbyllim rrugën? Kjo ishte e para.

E dyta, po të shkojmë te neni 3 i të njëjtit ligj, ku flitet për kriteret e pajisjes me aktin e marrjes së tokës në pronësi, në germën “a” thuhet: “E përdorin tokën për veprimtari bujqësore dhe e kanë aktin e marrjes së tokës në përdorim, të lëshuar deri në datën 15.08.2008”. Pra, këtu biem paksa në kundërshtim.

Erion Braçe – Është te propozimet e mia kjo?

Vullnet Sinaj – Jo, por propozimi juaj bie në kundërshtim me këtë nen, që kufizon datën 31.12.1993.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Zoti Vullnet, së pari, unë jua thashë pse është vendosur data 31.12.1993, por, mbi të gjitha, këtë datë e ka vendosur edhe një vendim i Këshillit të Ministrave, që është ende në fuqi dhe që përdoret.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, e kam përpara.

Përfundimi i zbatimit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kujt?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, por vendimi nr. 452, datë 17.10.1992 i Këshillit të Ministrave përdor si afat fundin e vitit 1993 për ndarjen e tokës. Unë po ju them se mund ta verifikoni fare lehtësisht në të gjithë territorin e vendit se toka dhe ndërmarrja bujqësore janë ndarë deri në fund të vitit 1993. Çfarë ka ndodhur më pas mund të kenë qenë raste shumë më specifike, sporadike, që mund të jenë pajisur në përputhje me ligjin, por jashtë këtij afati, pra duke e shkelur këtë afat. Bëhet fjalë për toka që janë lënë përsëri në përdorim dhe pjesa tjetër që ka qenë pastaj abuzive thuajse thelbësisht. Megjithatë, mund ta shohim këtë mospërputhje dhe ta diskutojmë pa asnjë lloj problemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Ja, një sekondë!

Zoti Sinaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Po, po.

Vullnet Sinaj – Kur të kem radhën për të diskutuar, do ta trajtoj përsëri.

Eduard Shalsi – Në rregull.

Edhe një herë, jemi te pyetjet.

Fjalën e ka zoti Baraj.

Besnik Baraj – Kam një pyetje. A mendoni se ka rrezik të fillojë historia që ata mund të kenë ardhur pas vitit 1993 dhe pastaj të nxjerrin dëshmi nga fqinjët se kanë ardhur para vitit 1993 dhe të kalojnë, ku ta di unë, në procese gjyqësore...?

(Deputeti Braçe flet pa mikrofon.)

Erion Braçe – ...më 31.12.1993.

Përgjithësisht, shikoni, zona që unë mbuloj ka pasur një fluks të paimagjinueshëm të ardhurve dhe nuk ka ndodhur që të ketë ardhur dikush tjetër përveç banorëve apo familjeve bujqësore, të cilat kanë ardhur vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave dhe për nevojat apo veprat industriale që janë ndërtuar në Veri të vendit. Vetëm ata mund të kenë ardhur para dhe pas vitit 1993. Ndërkohë, pjesa tjetër e familjeve ka ardhur, madje, edhe para gushtit të vitit 1991 qoftë nga Librazhdi, nga Gramshi, nga Pogradeci; kanë ardhur plot nga Korça, nga Skrapari; kanë ardhur nga Berati, nga Kukësi, që janë vendosur në ato territore dhe, të cilave, po e përsëris, ne u vendosim dy kushte.

E para, të provojnë se kanë ardhur faktikisht në atë periudhë dhe, e dyta, që është shumë e rëndësishme, të provojnë se nuk kanë marrë tokë në territorin ku kanë qenë më herët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se nuk kanë marrë tokë atje. Këtë gjë duhet ta provojnë me dokumente. Në të kundërt, e drejta e tyre mbaron pikërisht në këtë kufizim që ne kemi vendosur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Edhe unë dua ta përgëzoj dhe ta falënderoj kolegun Braçe për nismën dhe për zgjidhjen e një problemi kaq të rëndësishëm!

U përmend pak rasti i Divjakës, por unë do të desha të di edhe nga ju, edhe nga përfaqësuesit e ministrisë, një shifër të përafërt ose të dhëna të përafërta se sa familje mund të përfitojnë nga kjo gjë. Cili do të jetë impakti i këtyre ndryshimeve ligjore?

Duke qenë se ka lindur si një problem i zonës në Bashkinë Divjakë dhe ju, si deputet, besoj se e keni diskutuar me familjarë aty, me banorë, të cilët e kanë shprehur problemin dhe kjo është baza e nismës tuaj, unë dua të di: cili do të jetë konkretisht impakti? Çfarë do të ndodhë që nga momenti kur të miratohet dhe të hyjë në fuqi kjo gjë? Cilat janë hapat që do të ndërmerren?

Në relacion vura re, madje ju thoni se duhet shoqëruar nga ministria edhe me disa ndryshime në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave. Cila do të jetë sfida më e madhe për ta zbatuar dhe si do të sigurohemi që vërtet kjo gjë, kjo nismë kaq pozitive, do të implementohet deri në fund, duke sjellë një impakt pozitiv për familjet? A ka ndonjë sfidë të madhe, ku duhet të ketë kujdes ministria, ne si komision, për të monitoruar zbatimin e saj? Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Po, zoti Marto.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, zoti Braçe, sepse edhe pyetja e zotit Marto është në vijimësi.

Erion Braçe – Në rregull.

Eduard Shalsi – Urdhëroni, zoti Marto!

Andrea Marto - Duke e përgëzuar zotin Braçe, pyes: nëse këto amendime kalojnë, a mendoni se këto procedura për të gjitha këto familje mund të realizohen deri më 30 qershor 2019? Ndoshta, mund të duhet një afat më i gjatë.

Erion Braçe – Fillimisht, faleminderit, zonja Gjermani!

Unë desha t'ju them se numri i familjeve përfituese vetëm për ndryshimin e para dhe pas gushtit të vitit 1991, të shtuar me ndryshimin e vendbanimit, që është vënë si kriter në ligjin aktual (jo në nismën time), që e ndërpret procedurën për marrjen e tokës në përdorim,

janë 1060 familje, të cilat implikojnë gjithsej rreth 2000 ha tokë, vetëm në Bashkinë e Divjakës.

Në dijeninë time, veçanërisht zona e Myzeqesë përfshirë Lushnjën dhe Fierin, e bën problematikën shumë herë më të madhe se kaq. Ju thashë se ndërmarrjet bujqësore në këtë territor për shkak të zhvillimit intensiv të bujqësisë në periudhën para viteve '90, kanë qenë të shumta. Sipërfaqja e tokave që kanë administruar, ka qenë e madhe. Natyrisht, edhe zhvendosjet në këto zona kanë qenë të tilla, të mëdha. Ato janë bërë për 1001 arsye, veçanërisht në periudhën e tranzicionit midis dy sistemeve në këto territore.

Unë besoj se shifra përtej Divjakës është shumë herë më e madhe se kaq, por edhe po të nisesh me logjikë, se nuk i kam shifrat tani, duke filluar nga Shkodra, mbi dhe NënShkodër, për të vazhduar me Lezhën, Krujën, Fushë-Krujën, Laçin, Durrësin, Kavajën, Lushnjën, që përfshin Divjakën, Rrogozhinë, Lushnjë, Fierin, Vlorën (po marr vetëm pjesën e Ultësirës Perëndimore) dhe, duke vazhduar me Gjirokastrën dhe në fund, me Fushën e Vurgut, poshtë në Sarandë, mendoj se problemi është kombëtar dhe nuk është vetëm për Divjakën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, edhe Korçën, por mora thjesht dhe vetëm pjesën e Ultësirës Perëndimore, sepse të them të drejtën NB janë krijuar dhe lëvizjet demografike e implikojnë akoma më shumë problemin dhe kështu, ky bëhet një fenomen kombëtar, të themi të drejtën. Siç ju thashë, unë kam të detajuara vetëm shifrat për bashkinë e Divjakës.

Zoti Marto, afati 6-mujor nuk është fare i mjaftueshëm. Unë kam qenë nën presionin pozitiv të ushtruar edhe nga ministria me disa spote publicitare gjatë kësaj periudhe dhe me angazhimin e saj për ta udhëhequr këtë proces deri në datën 31 dhjetor 2018. Për këtë arsye, jam detyruar, pavarësisht se ekspertët me të cilët jam konsultuar, veçanërisht ata që merren me menaxhimin e këtij problemi në zonën e Myzeqesë dhe të Divjakës posaçërisht, ideja ka qenë që të mos ketë afat, sepse fluksi i njerëzve, që paraqiten çdo ditë në zyrat e regjistrimit të pasurive, ku më lejoni t'ju them, se kapacitetet e burimeve njerëzore, përtej problemeve të tjera, që lidhen me korrupsionin dhe me çdo gjë tjetër, që është prezent, nuk e mohojmë dot e të tjerat me radhë, është shumë i madh. Duke i shtuar edhe këtë kategori do të ishte edhe më i madh dhe ju keni të drejtë. Afati deri në qershor është i pamjaftueshëm, por unë pres pas mbledhjes së Komisionit të Ligjeve, nëse qeveria ka edhe ndonjë zgjidhje tjetër lidhur me afatin, por brenda nëntorit të këtij viti, sepse më 31 dhjetor këta njerëz do të jenë në ajër. Këta njerëz edhe sot që flasim, i ndalon ligji të paraqiten në zyrat e regjistrimit të pasurive, me përjashtim të atyre që janë zhvendosur në

këto zona me VKM për të cilët është mundësia, por afati fizik nuk i lejon të mund të paraqiten në zyrat e regjistrimit të pasurive për të marrë certifikatat e regjistrimit të pronësisë. Shqyrtimet atje janë për vite të tëra me radhë mbrapa.

Eduard Shalsi – Dakord.

Kush e do fjalën? Urdhëroni!

Dritan Bici - Kjo është një lloj rishpërndarjeje e tokës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më vjen keq! Unë kështu e konsideroj, sepse kështu ndodh në vendin tonë. Është një lloj kategorie, që deri sot (për 27 vjet), nuk ka pasur certifikatë pronësie dhe në këtë moment i jepet. Kështu, do të fillojnë të aktivizohen.

Unë jam dakord që kjo të bëhet dhe unë e inkurajoj zotin Braçe, por do të thosha në mbështetje të kolegut Marto, se më duket një periudhë e shkurtër që të përfshihen të gjitha problemet, sepse në momentin që po flasim, shumë pak kanë dijeni rreth kësaj pune. Mendoj se duhet të ketë një veprimtari të madhe të elementeve, duke filluar nga ne, deputetët, apo nga ju, që e keni ndërmarrë këtë punë për t'ua bërë të ditur.

Këtu është edhe një kategori tjetër (nuk e di nëse ju ka shpëtuar), që ka të bëjë me tokën në përdorim, siç janë specialistët e bujqësisë. Nuk e di a përfshihen...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, se nuk e kam dëgjuar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Ka dy gjëra. Nuk bëhet fjalë për rishpërndarje fizike të tokës, se këta njerëz e kanë marrë tokën dhe e kanë me akt të marrjes së tokës në përdorim. Nga viti 1991 e këtej, ata e përdorin këtë tokë fizikisht. Atje është vendosur ekonomia bujqësore e këtyre familjeve bujqësore. Ata kultivojnë në këto toka, por ligji i ka kufizuar me disa nene, që këta të marrin tokën në pronësi.

Ndërkohë, te kategoria që thashë, te punonjësit që ishin punonjës shteti, kur u nda toka, nuk kanë qenë vetëm specialistë bujqësie, sepse toka është shpërndarë edhe tek të tjerët. Unë kam në ato territore mësues të asaj periudhe, që kanë marrë deri në 4000 m² tokë, si familje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe specialistët e bujqësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Shqetësimi që unë kam tani, është që këtyre njerëzve që u është dhënë toka në përdorim që në periudhën 1991-1992, e kanë marrë këtë tokë në përdorim dhe e kanë lënë djerrë, saqë sot ne nuk identifikojmë dot territore të caktuara në atë zonë se kush i ka në përdorim. Ata janë vetëm në regjistra, por fizikisht këta njerëz kanë ikur fare nga Shqipëria prej vitesh dhe toka ka mbetur atje e pazhvilluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo është histori tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, për ata ka një nen tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Zoti Bici,

Tek informacioni që do të kërkojmë nga Ministria e Bujqësisë, se në fakt ka kohë që flitet dhe lajmi i mirë është që po përgatiten këto dy ligje. Ajo që presim është kur do të jenë gati dhe cilat janë kategoritë që do të përfitojnë. Pra, ka shumë kategori, ndaj duhet të informohemi se për cilat kategori bën fjalë ligji.

Po, zoti Leka.

Edmond Leka – Kam një pyetje të shkurtër për Erionin.

E falenderoj shumë për nismën që ka marrë, sepse ka ardhur në kohën e duhur! Në qoftë se nisma që Erioni po ndërmerr nuk realizohet brenda datës 31. 12. 2018, çfarë do të ndodhë? Kam edhe një pyetje për të sqaruar qytetarët, të cilët janë të shqetësuar dhe po na pyesin nëpërmjet mesazheve. Qytetarët duhen sqaruar që ligji nr. 7501 nuk preket dhe kjo nismë nuk ka lidhje fare me këtë ligj. Duhet sqaruar, sepse vetëm tani mua më kanë ardhur dy mesazhe për ligjin nr. 7501. Faleminderit!

Eduard Shalsi – Qartë.

Erion Braçe – Të dyja nismat nuk kanë lidhje fare me ligjin nr. 7501. Ai ligj është një histori tjetër e pandryshuar, e paprekur dhe unë nuk kam ndër mend të zgjidh problematikat ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Në fakt, këtu bëhet fjalë vetëm për tokat që kanë qenë në administrim të ndërmarrjeve bujqësore dhe që rregullohen me ligj tjetër

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, për ndërmarrjet bujqësore. Nuk ka lidhje me gjë tjetër.

Nuk ka lidhje me tokën që sot është e lirë dhe që mund të filloj të shpërndahet apo i merret dikujt dhe i jepet dikujt tjetër. Bëhet fjalë për tokën që është ndarë që në atë periudhë, por që ligji e kufizon në disa pika për të marrë certifikatën e pronësisë.

Shqetësimi im lidhet me datën 31. 12. 2018. Çfarë do të ndodhë në datën 31 dhjetor? Duhet dhënë një zgjidhje, sepse këtyre njerëzve u ngelet toka në përdorim. Toka në përdorim, në tituj juridik, në regjistra është tokë shteti. Ky është problem shumë i madh. Duhet nxitur edhe qeveria. Nëse ka dy nisma që përfshijnë edhe këto dy nisma, siç ministri i Bujqësisë tha në komisionin tjetër, pa asnjë lloj diskutimi duhet nxitur që t'i jepet një zgjidhje juridike brenda datës 30 nëntor të këtij viti me qëllim që të jetë koha e mjaftueshme për hyrjen në fuqi të ligjit në datën 1 janar. Këta njerëz të meritojnë që, pas kaq vitesh që punojnë tokën, të mos jenë as ankth e as në panik nga problematika që vjen nga mbarimi i afatit të veprimit të këtij ligji.

Eduard Shalsi – Nëse nuk ka pyetje të tjera ...

Ilir Ndraxhi – Pse duhet të zgjatet afati deri në datën 31. 12. 1993? Pse duhet të pajisen deri në atë datë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Arsyeja është se përgjithësisht në shumicën dërrmuese të territorit toka është ndarë deri në atë datë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur nuk ka tek unë, s'besoj se ka gjëkund tjetër.

Eduard Shalsi – Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Edhe unë nuk mund të rri po iu bashkuar falënderimeve që kolegët bënë për Erionin, por dua ta prek pak problemin nga ajo çfarë u diskutua në Komisionin e Ligjeve, meqenëse unë e ndoqa atë mbledhje. Në mbledhje ishte ministri i Bujqësisë dhe zëvendësministri i Drejtësisë. Qeveria aty kërkoi që komisionet parlamentare të mund të vazhdojnë trajtimin e nismës duke u harmonizuar me çfarë po përgatit qeveria. Unë jam pak i shqetësuar me atë çfarë kërkoi qeveria dhe me datën 31 dhjetor.

Ministri tha që grupi i punës ka afat deri në fund të vitit. Jo qeveria. Në qoftë se ne duam që qeveria të na e sjellë në datën 30 nëntor do të thotë që, në procesin normal që ka vetë qeveria, grupi i punës ta mbarojë në datën 15 nëntor. Mua më duket e pamundur që grupi i punës ta mbarojë në datën 15 nëntor.

Së dyti, ato projektligje kanë shumë më tepër se kaq. Unë besoj që debati në parlament do të dojë kohën e vet, aq më shumë që në dhjetor ne jemi të zënë me buxhetin dhe paketën fiskale. Madje, do të ishte shumë mirë që ne të bëjmë përpjekjet maksimale edhe në rrugë individuale që në atë debat të jenë edhe përfaqësuesit e opozitës, të paktën në komisione, pavarësisht nga vendimi politik që kanë marrë.

Ministri i Bujqësisë tha sot që janë shpërndarë 450 mijë AMTP dhe 200 mijë prej tyre nuk kanë akoma certifikatë pronësie. Ne kemi zgjidhur pas 25 vjetësh rreth 60% të rasteve.

Unë personalisht i propozoj komisionit që ne të vazhdojmë me këtë nismë, sepse minimalisht *...(nuk dëgjohet)* nuk e zgjidhin problemin, por hapim zgjidhjen e problemit. Nuk e dimë si do të vazhdojë historia, sepse mund të jetë shumë e gjatë. Minimalisht, jam i bindur që të paktën për ato 3 mijë hektarë, që kolegu Braçe tha se janë në Divjakë, edhe vitin tjetër nuk marrin dot leje nga AZHBR-ja, sepse nuk kanë dokumente. Këtë vit ne e lehtësuam shumë procesin me AZHBR-në për zero dokumente në aplikim, por pasi u shpallën fitues, përsëri gjysma e tyre nuk i bënë dot dokumentet. Nëse 3 mijë hektarë janë në Divjakë, në Shqipëri ndoshta mund të shkojnë 20 mijë apo 30 mijë. Një zonë 3 mijë hektarë, me shumë potenciale bujqësie dhe ku të gjithë po merren me bujqësi, ka krijuar një efekt zinxhir, në kuptimin e mirë të fjalës. Unë i propozoj komisionit që ne ta vazhdojmë këtu sikur e kemi për të enjten tjetër në seancë. I lëmë kohë vetes që brenda kësaj jave, edhe nëpërmjet organeve të Kuvendit, të komunikojmë me qeverinë për të parë nëse e sjell dot në datën 15 nëntor materialin e grupit të punës, ndryshe bëhet e pamundur.

Kështu që, përveç zgjidhjeve të mëdha, kur kemi 200 mijë pa zgjidhur, të zgjidhin 2 mijë nuk është keq. Për t'i hyrë një për një, me të gjitha datat, do të marrim informacionin e plotë nga ministria për të parë se sa i mundshëm është për t'u bërë, ndoshta do të na duhet të komunikojmë edhe me ZRPP-në për të parë se në çfarë faze janë dhe të tjera.

Propozimin e kam në parim pa hyrë te nenet, sepse edhe Komisioni i Ligjeve e la *on hold*. Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Beqaj!

Përveç përfaqësuesve të ministrisë, që do të vijjnë të hënën ose të martën, ne do të caktojmë një datë dëgjese edhe për institucionet e tjera me të cilat duhet të komunikojmë.

Inkurajoj deputetët që mbulojnë zonat rurale që të azhurnohen me informacion për këtë problematikë në zonat e tyre, në mënyrë që të dimë se për çfarë po flasim dhe çfarë impakti do të ketë.

Fjalën e ka zoti Braçe.

Erion Braçe – Të nderuar kolegë, ky është njëri nga shqetësimet brenda 200 mijë akteve të marrjes së tokës në përdorim që ne kemi sot. Por, nëse në 200 mijë akte që ministri relaton, problemi është te kapacitetet e pamjaftueshme në zyrat e regjistrimit të pasurisë dhe bashkitë që ndjekin procedurat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po marr vetëm anën administrative, bashkitë dhe zyrat e regjistrimit të pasurive kanë kapacitete të limituara për t'ju përgjigjur familjeve bujqësore që paraqiten në zyra. Kjo kategori për të cilën po flas ka dy probleme shumë të rëndësishme: datën 1 gusht të vitit 1991 dhe vendosjen në raport me këtë datë dhe ndryshimet e vendbanimeve e të tjera, që i ndalon ligji të pajisen me certifikata pronësie. Fuqia e këtij ligji mbaron në datën 31 dhjetor 2018. Ky është shqetësimi që unë kam, përtej panoramës së madhe që me të drejtë bën ministri, por që lidhet edhe me kapacitetet administrative. Shqetësimi ka lindur dhe është bërë agresiv për shkak se këta njerëz drejtohen në institucionet vendore ku kryejnë procedurat për t'u pajisur me certifikata pronësie. Këta njerëz deri tani nuk e kanë ditur që i ndalon ligji ta marrin tokën në pronësi. Ky është shqetësimi. Afati që qeveria duhet t'i përgjigjet duhet të jetë fundi i muajit nëntor dhe ky duhet të jetë shqetësim edhe për qeverinë.

Ministri në komisionin tjetër tha që kemi ngelur në një pikë. Të konsumohen 20 ditë pune për një pikë, këtë nuk e kuptoj. Një pikë mund të zgjidhet edhe brenda ditës, le të ulen me njeri-tjetrin 24 orë dhe të gjejnë një zgjidhje përfundimtare, nuk mund që të shtyhet në kohë, sepse nuk ka sens. Qeveria të bëjë të gjitha përpjekjet që ta miratojë brenda muajit nëntor këtë gjë, nëse në nismat e tyre përfshihen edhe këto ndryshime që unë kam paraqitur.

Eduard Shalsi – Fjalën e ka zoti Bitri!

Robert Bitri – Unë jam dakord për nismën, por mbështes Ilirin që ne të ecim hap pas hapi duke mos pritur paketën. Ashtu siç tha edhe zoti Braçe, që afati mbaron në datën 31 dhjetor dhe ky afat të shtyhet nuk ka kuptim, prandaj është e domosdoshme që në takimin që do të bëhet të jenë edhe dy faktorë: ZRPP-ja dhe Shoqata e Kryetarëve të Bashkive, sepse edhe ata mund të ndihmojnë nëpërmjet komisionit të ndarjes së tokave në rrethe. Është shumë kollaj të themi që mbaroi në letër, por realisht a mbarohen? Bëhet një përllogaritje me këto punonjës që kanë bashkitë, sa punonjës do të vihen në dispozicion të këtij problemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra bëhet një përllogaritje matematikore shumë e rëndësishme e afateve që preken apo nuk preken. Në takimin që do të bëhet të jenë edhe këta dy faktorë të rëndësishëm, të

cilët sot kanë marrë përgjegjësinë kryesore për të arritur këtë afat që kërkohet. Siç e tha edhe kolegu, ne nuk duhet të lëmë datën 30 qershor, sepse nuk arrihet.

(Erion Braçe flet pa mikrofon)

Erion Braçe – Në regjistrat juridikë të shtetit, titulli juridik është “Tokë shtet”.

Eduard Shalsi – Zoti Braçe, të falënderoj për prezencën!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur sot? Jo, do ta bëjmë ditën e hënë ose të martën dhe duam një prezantim të problematikës në rang vendi, duke respektuar datën 30. Duke parë synimin që ka grupi i punës, ndërkohë ne vazhdojmë punën, sepse nuk na pengon asgjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që do t’ia kërkojmë.

Ilir Beqaj – Për Ministrinë e Bujqësisë kam dy kërkesa. E para, nëse keni informacion ose mund ta hartoni deri javës tjetër, siç solli zoti Braçe nga bashkia e Divjakës për këtë lloj rasti, sa raste janë në rang vendi.

E dyta, ne vjet në nëntor e kemi shtyrë afatin, nga nëntori i vitit të kaluar dhe deri tani çfarë ka ndodhur? Në relacionin e nëntorit na keni pas thënë 2300 kërkesa.

Eduard Shalsi – A kemi nisur ndonjë kërkesë zyrtare për këtë afat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo ka qenë pjesë e informacionit që do të kërkonim nga Ministria e Bujqësisë.

Erion Braçe – Më falni, zoti Shalsi, nëse më lejoni për një ndërhyrje të fundit. Edhe një herë duhet bërë diferenca mes gjithë atyre që e kanë pasur mundësinë që të ndjekin procedurën e marrjes së tokës në pronësi, që ua ka dhënë ligji dhe këtyre të tjerëve që ligji nuk ua jep këtë mundësi për ato arsye për të cilat thashë. Kjo është tipologjia që ne kemi studiuar dhe kemi ndarë më vete në Divjakë.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Mbledhja mbyllet. Mbledhja e radhës nesër në orën 9:00.

MBYLLET MBLEDHJA